REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 30.05.2025 Prot.38 (tridhjetëetetë)

Protokoll nr. 38

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 17.03.2025.dhe 28.03.2025.
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin prill 2025";
5.P-V"Për një ndryshim në buxhetin e bashkisë Maliq për vitin 2025";
6.P-V "Për rishpërndarjen e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025";
7.P-V "Per miratimin e Raportit të I-rë të Monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2025";
8. P-V "Mbi mbështetjen financiare të aktivitetit kulturor 3 ditor *"SINEMANIA"*;
9.P-V"Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor";
10.P-V "Për nxjerrjen nga përdorimi dhe heqjen nga regjistri i aktiveve, të disa objekteve të transferuara nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr.2548 prot., datë 15.05.2017";
11.Raporti për sondazhin, prioritet e qytetarve për tavanet përgatitore të buxhetit viti 2026.
12.Raport mbi gjendjen e kopshteve në territorin e bashkisë Maliq.
13.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Ronaldo Skënderi; Marinathi Avrami; Xhuana Hoxhallari; Pranvera Begolli; Eriseld Jonusllari;Danjela Ibrahim; Dritan Çami; Petrit Kupe; Floreta Zaçe; Klea Baçi; Kristina Malelli; Albina Xhejo; Yllson Ibrahimllari; Almir Elezi; Andonaq Risto; Neresida Shindo; Faslli Zholi;Dalina Krekas; 19 (nëntmbëdhjetë) këshilltarë

Mungesa: Idlir Limllari; Gentiana Drabo; Rovena Terolli; Plator Çollaku; Fevri Sherifi; Enida Avdolli; Aramando Dautllari; Ilia Xhuti; Server Xhuti; Eglantina Balli; Lulëzim Hoxhaj; Marjeta Xhelollari; 12 (dymbëedhjetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Drejorisë të Financës dhe Buxhetit; Almira Muka; Drejtori i Pronave Publike dhe Asteve; Andi Sula; Drejore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti; Përgjegjës Sektori Pyje-Kullota; Klarsen Brako.

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve! Të nderuar kolegë Këshilltarë, i nderuar Kryetari i bashkisë, të nderuar pjesmarës, fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak, ashtu sikur jeni njoftuar, verifikojmë korumin, korumi realizohet sepse janë 19 Këshilltarë në sallë, mund të vijojmë me mbledhjen.Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës, me dy shtesa P-V për dhënien në përdorim të disa mjeteve Agjencisë të Shërbimve Mbështetës dhe P-V tjetër është si propozim i 12 kolegeve tanë, iniciuar nga kolegu jonë Yllson Ibrahimllari për një korigjim vendimi të marrë nga Këshilli në vitin 2021, kur të jemi atje do ja japim fjalën specialisteve të na shpjegojnë më mire.Miratojmë rendin e ditës? Me këto dy shtesa.

Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota rendi i ditës, Faleminderit!Tani më lejoni tju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar, janë gjithësej tre vendime, të treja me karkater kolektiv.Ju ftojmë të miratojmë proceverbalin e mbledhjes së kaluar janë dy proceverbale të dy mbledhjeve 17.03.2025 dhe 28.03.2025.

Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohen me 19 vota proceverbalet e mbledhjeve të kaluara, Faleminderit! Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës, .P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin prill 2025"; Te ndihma ekonomike kush e do fjalën? Po Neresida.

Neresida Shindo: Kam shkurar dhe te grupi i Komisionit, kemi kërkuar dhe një riformatim të Komisioneve, diçka që po shtyhet dhe nuk po bëhet! Këto Komisione janë jo funksionale, sidomos Komisioni ku unë bëj pjesë, kam shkruar te grupi dy ditë para dhe nuk kam marrë përgjigje.Kështu që mendoj të riformatohen sa më shpejt se nuk janë funksionale.Faleminderit!

Yllson Ibrahimllari: Kisha diçka, me që filluam të shqyrtojmë pikat e rendit të ditës, ne na vijnë materialet nga ekzekutivi në bazën e një relacioni dhe normalisht, i falenderojmë për punën që bëjnë, por nuk duhet të harojmë dhe punët që ne kemi, ekzekutivi për atë pahuhet vjen dhe sjell relacionet, unë besoj se në çdo mbledhje të gjitha Komisionet e Këshilit të kenë një relacion të përbashkët që do i bashkangjitet çdo projekti që na vjen, ne nuk jemi specialistë të të gjitha fushave, falenderojmë ekezekutivin që është i përpiktë dhe korekt në ato që sjell, pavarshisht qëndrimeve që kemi me objeksionet tona, unë mendoj që ne si Këshill nuk duhet të kalojmë asnjë material pa ardhur relacioni nga Komsioni përaktës, ai Komision duhet ti sjelli Këshillit atë relacion, mendoj që kjo mbeldhje të shkojë në vazhdën e mbeldhjeve të tjera dhe duke filluar nga

mbeldhja e radhës, ne mos kalojmë as një pikë të rendit të ditës pa material dhe relacion shoqërues të Komisionit përaktës.Do doja para kësaj që një znj e nderuar që punonte në bashki ka ndruar jetë të mbanim 1 minutë heshtje.Faleminderit!

Pranvera Begolli:Për sa i përket relacioneve të Komisionit të Financës, të gjitha pikat kanë relacion shoqërues.

Ornildi Demollari: Faleminderit! E kalojmë në votim pikën 4?

Kush është dakord?18 vota pro.
Kundra? 1.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 18 vota pro 1 kundra, Faleminderit! Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës, P-V"Për një ndryshim në buxhetin e bashkisë Maliq për vitin 2025"; Po Kryetar i Komisinit të Financës.
Petrit Kupe:Përshëndetje të gjithve! Shqetësimi që ngre kolegu, ka si qëllim që Komisioni të funksionojë dhe ta pasqyrojë punëne tij dhe në praktikëne mbeldhjes së Komisionit të Financës, ne mblidhemi diskutojmë atje së çfarë miratojmë dhe shkruajmë se çfarë sygjerojmë, kështu ndodhi dhe në mbeldhjen e fundit, Sekretari i Këshillit bën gati materialet dhe gjendet i depozituar i gjithë diskutimi që bëjmë në Komision.Për sa i përket pikave që kanë të bëjnë me Komisionin e Financës dhe këto ne i shqyrtuam, do flas për pikën 5 dhe 6, për dy pikat e tjera Këshilli dhe gjithë ata që na shohin kanë nevojë për më shumë sqarim, janë disa aktivitete që duhen të njihen dhe jo vetëm ne për mes shkesës, si për projektin e Intregut dhe Sinemania, për pikën 5 ka një ndryshim në buxhet, pakësohen disa fonde të kursyera nga prokurimet dhe përdoren po këto fonde për disa projekte të tjera të cilat i duken të domsdoshme bashkisë, duke përdorur kursime që kanë të bëjnë me shpenzimin e kompesimin e pronave për zgjerimin e varrezave në disa fshatra, nuk e di a janë të mjaftueshme këto fonde, këtë mund të na i shpjegojnë dha ka të bëjë me fondin për kolaudimin e ujësjellsit rajonal, kështu që ne jemi dakord që ky projket të kalojë sa më parë dhe të miratohet nga ana e Këshillit.Për sa i përket P-V nr.6, ka të bëjë me financimin e disa projekteve që bashkia Maliq ka konkurar dhe kërkon të mbështeten me fonde për një përiudhë disa vjeçare, për P-V e tjera të cilat kanë të bëjnë me financën ne jemi dakord por kërkojmë një shpjegim më shumë për tu njohur komuniteti, këto kishim.
Ornildi Demollari: Faleminderit! Po e qartë.Kryetar do shtosh diçka te pika 5?
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Përshëndetje të gjithve!Ashtu si e kemi shprehur në relacion, por besoj se dhe P-V është i qartë, janë fonde të cilat janë kursyer nga prokurimet publike dhe përdoren për interes të bashkisë në zëra që kanë qenë të paplanifikuara ose në këtë moment janë bërë të domozdoshme, në zbatim dhe të shqetësimit që kanë patur Këshilltarët por dhe komuniteti për zgjerimin e varrezave publike, ka dalë e domozdoshme kjo pikë, gurpi i punës Dr e pronave dhe Drejtori të tjera kanë punuar në terren, kanë evidentuar të gjitha shqetësimet, mund të kemi shqetësime dhe në vende të tjera, por ky le të jetë hapi i parë, më rezulton që dhe Vashtëmia ka probleme, të cilën Dr e Pronave duhet marrë në konsideratë shpejt.Sipas relacionit, do bëjmë një ndërhyerje në Podgorie, në Sovjan, në Pojan, Zëmblak dhe Vloçisht për efekt të zgjerimit të varrezave dhe për qëllim të asaj që duam të arrijmë, jemi të

detyruar të kryejmë shpronësim për efekt të banorve që kanë tokat rrotull varrezave ekzistuese, pika tjetër ka të bëjë me kolaudimin e ujësjellsit të Mançurishtit, jemi në fazën e mbylljes të atij projekti, dojsa është dorzuar dhe është në fazë kolaudimi dhe janë të domozdoshme ligjërisht dhe këto fonde.Kaq për pikën 5.Nuk shtojmë fonde, por janë fonde të kursyera nga ne nga prokurimet publike.

Ornildi Demollari: Faleminderit Kreytar! Kemi diçka tjetër këtu te pika 5 ? E kalojmë në votim pikën 5?

Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka .
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota pro pika 5, Faleminderit! Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës, P-V "Për rishpërndarjen e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025"Komisioni i Financës u shpreh, po Kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ne sapo jemi shpallur fitues të një projketi me fondet e BE programi "Intereg", është nga projektet e para të fituara, kemi fituar dhe një projekt tjetër përsëri nga BE, ky projekt ka të bëjë me mjedisin.Jemi në rrugë të mbarë për të përfituar projekte komunitare nga BE, ajo çka dua ti shpjegoj Këshilltarve, këto nuk janë lekë që i ikin buxhetit të bashkisë, por vetë programi, vetë fondet e BE të detyrojnë, fillimisht pagesat ti bësh me fondet e tua dhe pastaj lekët kthehen përsëri në buxhetin e bashkisë, kjo është një garanci për efekt të shpenzimeve buxhetore sipas projektit, ne i paguajmë fillimisht me fondet tona dhe kur vijnë faturat, ne çojmë faturat tek institucioni i BE dhe ata kthejnë lekët në të njëjtën sasi në buxhetin e bashkisë.Kështu që i gjithë fondi prej 2 milon, 4 milon dhe 5 milon lekë në tre vite buxhetore, është fond i cili përdoret për shpenzime administrative, buxhetore dhe pastaj kthehen përsëri dhe bashki nuk humbet asnjë lekë.E rëndësishmë është që zyra e projekteve e BE në bashki, ka filluar të jetë më freksibël, ka fituar deri sot dy projekte, synojmë të fitojmë dhe projekte të tjera, të cilat janë fonde i hyjnë buxhetit tonë, me projekti ku nuk shpenzojmë fondet tona ose të buxhetit të shtetit.Shumë faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! E kalojmë në votim pikën 6?

Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka .
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota pro , Faleminderit! Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës, P-V "Per miratimin e Raportit të I-rë të Monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2025"; Komisioni?

Petrit Kupe: Edhe këtë pikë e shqyrtuam paraprakisht dhe jemi dakord të miratohet.Për ne treguesit janë të mirë, me përjashtim të problemit vazhdomn të ekzisitojë, mos realizimi i të ardhurave sipas parashikimit, por ka një përmirësim, një rritje në krahësim me vitin e kaluar.

Ornildi Demollari: Faleminderit!Kryetar?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ky është një detyrim ligjor, për ti sjellë informacion jo vetëm Këshillit, por dhe qytetarve por dhe Ministrisë të Financave, mbi gjithë financat e bashkisë tonë, pëe 4-mujorin e parë.Ashtu si rezulton nga tabelat që ju kemi paraqitur, realzimi i buxhetit është në masën 40% për efekt të buxhetit vjetor, duhet të jemi të vetëdijshëm që ka qenë një

periudhë zgjedhore, një periudhë më e ngarkuar, nuk kanë qenë të ingranuar 100% si në faza të tjera, por ka dhe diçka tjetër, që Qershori është afati i fundit dhe për bizneset dhe familjarët, që janë të detyruar të paguajnë Taksat dhe Tarifat lokale, kështu që dhe kjo ka atë efektin e vetë.Por me gjithë atë na takon të gjithve pa përjshtim dhe Këshillit, por veçanërisht ekzekutivit dhe Drejtorisë përkatëse, të marrë masa për një realizim sa më efektiv të buxhetit të pavarur me gjithë elementët, pasi duke realizuar atë, kemi më shumë punë dhe më shumë shërbime ndaj komunitetit, e patjetër dhe më shumë projkete.Në zërat e tjerë, po të shikoni jemi në nivele të kënaqëshme, jemi pothuaj se në të gjithë zërat buxhetor, jemi më lart se një vit më parë, si në planfikim, menaxhim dhe administrim si në shërbime te Policisë, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri, Menaxhimi i Infrastrukturës Ujitse, Pyje-Kullota, Rrugë-Rurale, Kanalizme, Shërbime-Publike, Rrugë-Rurale-Vendore, është rritur dhe në programe Sociale, jo për efekt të rritjes të numurit të familjeve, por të rritjes së vlerës, në arsim e mesëm dhe të përgjithshëm ka pak ngadalsim të në investime, me të vetmen arsye, se jemi në fazë prokurimi ose është bërë inevstimi dhe nuk është bërë likujdimi, por në fakt shumë shpejt vlera do të jetë e konsoderushme.Janë plotësuar të gjitha tabelat sipas programeve, vlera nuk del reale në këtë moment për atë që thashë pak më parë, është bërë inevstimi dhe nuk është bërë likujdimi, për efekt të anës dokumentare për të kryer likujdmimet.Janë investime të buxhetit të shtetit, si në Ujitje-Kullim, apo dhe për pritat në Zëmblak dhe Plasë, të cilat janë në likujdim dhe efekti real do të jetë menjëherë.Po të analizojmë treguesit financiarë të vitit 2024 dhe planin e vitit 2025, raporti i shpenzimeve të përgjithshme ndaj të ardhruave të përgjithshme, rezulton 54.3% ky tregues, është në një nivel pozitiv dhe për vitin 2025 synojmë për ta realizuar 100%.Raporti i të ardhurave ashtu si e thashë ka një ngërç, i cili duhet të ngrihet në një nivel më lart, raporti o shpenzimeve me investimet kapitale është realizuar 14.6% me një tregues pozitiv gjatë vitit mendojmë ta përmirësojmë, raporti i shpenzimeve të personlelit 36.9%, nga 30.1% që ka qenë një vit më parë, kujdesi shoqëror 30.3%, një vlerë e konsiderushme në buxhetin e bashkisë, kemi rritje të pagesave për këtë kategori, detyrimit e prapambetura janë vetëm 2.2 milon lekë, një shifër minimale.Shumë faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar! E kalojmë në votim pikën 7?

Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka .
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës, P-V "Mbi mbështetjen financiare të aktivitetit kulturor 3 ditor *"SINEMANIA"*;

Floreta Zaçe:Përshëndetje! Për sa i përket P-Vnr.8 "Mbi mbështetjen financiare të aktivitetit kulturor 3 ditor *"SINEMANIA"*; Duke u dakortësuar me Komisionin e Financës menduam që ky aktivitet të kalojë për financim dhe të vazhdojë si aktivitet.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kryetar?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Është një aktivitet që e kemi realizuar dhe një vit më parë, për ne ka patur impakt, vlera nuk është e madhe, 3 ditë banorë të qytetit por dhe të zonës, le të krijohet një kulturë e tillë e përgjithshme.Ne po mendojmë që vetëm ky lloj aktiviteti, por dhe aktivitete të tjera kulturore që i japin gjallëri zonës tonë, po mendojmë që ky aktivitet të jetë dhe shëtitës, mos jetë 3 ditë Maliq, por mund të jetë 1 ditë Maliq dhe 1 ditë Pojan ose NJ.A tjetër,

nuk e di sa e mundur është teknikisht sepse duhet të lëvizin pajisjet dhe kosto mund të jetë më e madhe, nga ana tjetër aktivitete të mëdhenj kulturorë ku performojnë artistë të mëdhenj, ashtu si performojnë në gjithë Shqipërinë, mund të jenë pjesë dhe bashkisë tonë, për ti dhënë gjallëri dhe zonës tonë, po mendojmë këtë punë dhe besoj se do kemi dhe mbështejen e Këshillit.Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit Kreytar! Kemi diçka tjetër këtu ? E kalojmë në votim ?

Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka .
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota pro , Faleminderit! Kalojmë te pika 9 e rendit të ditës, P-V"Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor";
Faslli Zholi:Përshëndetje të gjithve, përshëndetje anëtarë të Këshillit, përshëndetje Kryetar i Bashkisë! U njoha me pikën, diçka që dua të shtoj këtu dhe nuk do e diskutoj më, kam pakënaqësi mbi Komisionet që nuk mblidhen, ditën që kemi marrë mandatin, ne jemi betuar para qyetetarve që kanë sjellë këtu dhe së dyti jemi betuar mbi Kushtetutën e Shqipërisë, Këshilltari kësaj salle duhet të jetë i përgjegjëshëm dhe të bëjë detyrën.Për sa i përket materialit unë pashë dhe vlen për të falenderuar, sepse është një pikë mbi zjarret, unë i kam parë ka një punë të mirë nga ana e Zjarrfikseve, por dua të shtoj dhe diçka që në këto grupet vullnetare që janë ngritur, a janë të trjanuar, na duhet një inforamcion për grupet e zjarreve dhe diçka tjetër lidhur me zjarret, ka një prerje masive të pyjeve, sidmos kohën e fushatës, të kemi dhe një informacion nga strukturat ligj zbatuese, si janë shkaqet e zjarrit, me qëllim? Për sa i përket prerjes të pyjeve, shikojmë makina, sidmos kohën e fushatës, ne diskutojmë ti ruajmë nga zjarri dhe i preim me dorën tonë, kjo për mua duhet të shikohet me përparësi dhe nga organet ligj zbatuese.Jam dakord ta miratojmë.Faleminderit!
Ornildi Demollari: Kemi diçka tjetër këtu te piak 9?
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë mendoj, që materiali mund të ishte më i plotë edhe Drejtoria përaktëse, mund të kishte dhënë një inforamcion më shumë, për punën që vëret kryhet në terren, jo vetëm nga Drejtoria, por dhe nga Kryetarët e fshatrave, Barnjitë në zona etj dhe nga ana tjetër do kërkoja Drejtoria përaktëse, të fillojë urgjentisht takimet në bazë me Administratorë, me Kryetarë fshatrash, për senzibilizim edhe që ti paraprijmë, mos na ndodhë ajo situatë e vitit të kalaur mbi Lozhan lart, në Bode, ku ishte një dëm i konsiderushëm dhe duhet ti paraprijmë, të kemi pika sinjalizuese sa më të shpejta, për efekt të mbrojtjes të kësaj pasurie, që mund të digjet për pak sekonda, por kërkon disa dhjetra vjet për tu bërë .
Ornildi Demollari: Faleminderit Kreytar! Kemi diçka tjetër këtu ? E kalojmë në votim ?

Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka .
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te pika 10 e rendit të ditës, .P-V "Për nxjerrjen nga përdorimi dhe heqjen nga regjistri i aktiveve, të disa objekteve të transferuara nga Ministria e Mjedisit me Aktin e Transferimit nr.2548 prot., datë 15.05.2017"; Kryetar do shtosh diçka?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Pas kam marrë shqetësimin e komuniteteve dhe drejtuesve tanë në NJ.A dhe sipas Drejtorisë të Pronave, vërjemë që disa objekte dhe Sektorit të pyje Kullltoave për tre prona, të cilat në fakt figurojnë në letra, por nuk figurojnë në terren, të kaluara nga Ministria e Mjedisit në vitin 2017, nuk kanë ndonjë vlerë të konsiderueshme rreth 20 milon lekë, Bofja e ka me vlerë kontabël më të madhe, sepse ka qenë godinë më e madhe edhe dy stacione magazimimi në Lozhan, të cilat janë në gjendje të mirë dhe ne duam ta reabiltojmë, kurse në Plasë nuk ekziston fare, në Moglicë është e rënuar dhe në Dushar është e rënuar.Në këtë kuadër edhe për ti hequr nga inventari, në Plasë ka një ndërtim, është Ferma e Bleteve, i cili e ka blerë kohë më parë, kam mbetur vetëm pjesa jonë, e cila nuk ka vlerë të madhe rreth 20.000 lekë dhe normalisht nuk na shërben.Kjo është me pak fjalë ajo që ju paraqisim.Tre godian i heqim nga ineventari dhe dy të tjera i lemë ashtu si kanë qenë.

Ornildi Demollari: Plasën, Moglicën dhe Bofjen?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po.

Ornildi Demollari: Kemi diçka tjetër këtu ? E kalojmë në votim ?

Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka .
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota pro, Faleminderit! Kalojmë te P-V që shtuam te rendi i ditës, P-V "Për dhënine e mjeteve për huapërdorje Agjencisë Mbështetsë";

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Janë mjete që ata i përdorin dhe mos jenë në inventarin e bashkisë, por të jenë në inventarin e tyre, për menaxhim, për riaprim, është një procedurë standarte, ashtu si i kemi kalaur dhe materialet e magazinës, po i kalojmë dhe mjetet të jenë në inventarin e tyre, kjo është me pak fjalë.

Ornildi Demollari:E kalojmë në votim ?

Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka .
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota pro, Faleminderit!Kalojmë te P-V tjetër që erdhi me 12 firmat e Këshilltarve bëhet fjalë për një vendim të marrë nga Këshilli Bashkiak i kaluar në datën 22.05.2021 "Për miratimin paraprak të planeve të mbashtrimit të pyjeve dhe kullotave në bashkinë Maliq"dhe propozimi i kolegut tonë Yllson Ibrahimllari, mbështetur nga 12 kolegë, është që ky vendim ka nevojë për një korigjim.

Yllson Ibrahimllari:Në vendimi që keni marrë ju si Këshill në vitin 2021, keni marrë një vendim parprak, kaq është fuqia e Këshillit, porcesi i ekzekutivit këtu është që e ka shoqëruar me relacione, por as Këshilli as Bashkia nuk janë hartues të këtij projketi.Ky projket është bërë nga një shoqëri private që quhet "Abcomsi", e cila për llogari të rekrutimit nga Ministria e Turizimit dhe Mjedist ka bërë këto harat bashkangjitur vendimit që ju keni miratuar në parim dhe ja keni transferuar Ministtisë përkatës të linjës e dhe Kadastrës, kemi vendosje jo të duhur të hartës të

trupës ujore.Në këtë konstatim që e kemi evidentuar, kemi biseduar me personat përkatës ne bashki dhe kemi inciuar, që ne do të ndërhyjmë dhe do ti drejtohemi Kadastrës dhe Ministrisë të linjës, këtë konstatim ta paregullësisë në produktin hartogarafik në ekonominë pyjore mesmal nuk paraqit realitetin dhe ka nuk ka këtë deviacion, pra ne thjeshtë po rregullojmë një produkt që nuk është në realitet, zotërinjtë Klarens Brako dhe Andi, kjo hartënuk pasqyron realitetin, ne nuk bëjmë produkut hartogarfik se nuk e kemi këtë kompetencë, Ministria i thotë shoqërisë që ka rekrutuar, që ka bërë projketin, ju lutem korigjoni produktin hartografik, kaq është thelbi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë mendoj që ky është një moment ekspertësh, sesa i bashkisë apo i këshillit, ndonjëherë dokumenta të cilët i kanë hartuar të tjerët, nuk mund të ndikojmë ne për këto dokumenta, ne mund të sygjerojmë.Studioja që ka bërë inventarizimin e të gjithë pronave në Pyje-Kullota, jemi një nga bashkitë e vetme në Shqipëri që e kemi bërë.Shkresa e inciuar nga Këshilltarët, duhet ti kalojë Drejrtorisë të Pronave në bashkis, Këshilli nuk ka çfarë vendimi të marrë sot.Këshilli mund ti drejtohet vetë, apo një grup Këshilltrësh, Agjencisë Kombëtare të Pyje-Kullota, që kemi një problem, duam saktësim, duam një zgjidhje etj.Ky është mendimi im.

Yllson Ibrahimllari: Insistimi për të mbajtur gabimin nga pakujdesia, na le të dyshojmë për disa gjera.Më lejoni tju lexoj P-V, pastaj me votë ju vendosni keni shumicën.P-V "Për shfuqizimin pjesor të VKB-së nr.37 datë 28.05.2021 dhe korigjimin e hartës respektive.Pika 1 bazuar në rregulloren e Këshillit Bashkiak neni 107, rishikimi i Akteve apo anulimi, shfuqizimi apo ndryshimi i tyre.Këshilli Bashkiak e ka këtë të drejtë me rregullore, ne si Këshilli, i kërkojmë Kryetarit të bashkisë, që pas verifikimit, të konstatimit të cituar në relacionin sqarues, ti drejtohemi Ministrisë të Mjedisit dhe Turizimit për ndreqjen e gabimit hartografik.Kërkojmë nga ana e Kryetarit të Bashkisë të na informojë për procedurat që do ndiqen hap pas hapi, deri në sjellen në Këshill të hartës të ndrequr, nëse e ka këtë kompetencë.Miraton nismën e Këshilltrave nëse e miraton, miraton ndjekjen e porcedurës hap pas hapi për korigjimin e gabimit të konstatuar në hartën e funksioneve ekonomia pyjore Mesmal, harta e mbashtrimit të të pyje dhe kullota bashkia Maliq që është hartuar në Janar të vitit 2021, për të eleminuar gabimet në vendimin e mëprshëm me nr.37 datë 28.05.2021, në paraqitjen hartografike në ekonominë pyjore Mesmal, deri në atë kohë ti drejtohemi Kadastrës, për bllokimin e rregjistrimit sipas VKB-së që keni miratuar në vitin 2021, me qëllim shmangjen e pasojave të pakthyehsme nga vendimi i më parshëm.Ngrakohet Kryetari i Bashkisë, të njoftojë Këshillin për procedurat, ky është propozimi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk po them që këshilli nuk ka të drejtë që të marrë një vendim dhe pas disa muajsh ta ndryshojë, nisma që ndërmer Këshilli, i vjen ekzekutivit, i shkon drejtorisë përkatës dhe ajo merret me të gjitha pikat dhe o ndjek o kthen përgjigje për atë situatë që është.

Yllson Ibrahimllari: Unë kam kontaktuar me Ministrinë dhe Ministria thotë që ka shumë paregullësi dhe Kadastra nuk po bën rregjsitrime, mbi këtë projekt që ka bërë Abcomsi, sepse ka

konstatuar mangësi, është e drejta e tyre.Sot është një drejtor Hipoteke që nuk do ta veri në zbatim këtë VKB, apo të Ministrisë, nesër vjen dikush tjetër dhe fillon rregjsitrimet dhe unë shkoj 4 vjet në Gjykatë Administrative të Shkallës të Parë, 4 vjet në Gjykatë Administrative të Shkallës të Dytë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë mendoj që materiali ti kalojë ekzekutivit dhe të shohim si mund të veprojmë.

Përgjegjës Sektori Pyje-Kullota; z.Klarsen Brako:Përshëndetje! Në Hipotekë nuk shkojnë planet e menaxhimit, por venë rregjistrimet që ka bërë Dateku, por nuk kundërshtoj që hartat kanë gabime.
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Materiali i firmosur nga 12 Këshiltarë, P-V bashkë me Relacion, të shikohet nga Drejtoria, të analziohet dhe të kërkohet nga Ministria përaktëse si do zgjidhet kjo situatë.

Ornildi Demollari: Po, jemi dakord kështu? Po Petrit.

Petrit Kupe: Dakord.Patjetër se atëherë mund të bëhet vendim, se tani e kemi P-V dhe akoma nuk e kemi të qartë.Por doja të thoja që,

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Materiali është voluminoz dhe mund të ketë dhe gabime të tjera në harta.

Petrit Kupe: Pse e ka kapur gabimin vetë? Drejtoria jo?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Sepse ka interes dhe Drejoria jo, materiali mund të ketë gabim dhe të zgjidhet, ne nuk kemi asnjë kundërshi, ti drejtohmi Ministrisë që ekspertët përkatës të shprehen për këtë punë.

Yllson Ibrahimllari: Ministrisë ti drejtohemi ose me shkresën Tuaj ose ti bashkangjitim dhe P-V dhe Relacioni e firmosur nga Këshilli.Gabimin e konstatoj unë që jam me profesion Ortoped, jo ata që janë Hartografë, le të thonë që ne na duhet sikur është e pa rregullut, ka q le ta thonë.E kanë këtë të drejtë? Apo jo?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë nuk mund ti them ta thonë. Nuk e di Andi çfarë ka? Se ka punuar dhe në Kadastër.

Drejtori i Pronave Publike dhe Asteve; z.Andi Sula: Përshëndetje të gjitheve! Ashtu si u tha dhe nga Klarseni që është ekpsert i fushës, por dhe vetë u pranua nga Këshillatri z.Ibrahimllari, që ky material nuk është përgatitur nga bashkia, ky material, i është servirur bashkisë për të punuar mbi të.Zyra që e ka për detyrë është, ASHK-ja sot.Me sy të lirë duket një gabim, por brenda asaj planshete mund të ketë dhe gabime të tjera, të cilat nuk e kemi ne as tagrin , as bazën ligjore për ti korigjuar, por e ka Ministria përkatëse me kompaninë që ka kontraktuar, nëqoftë se

do kërkohet ndihma nga ana jonë për ta iniciuar me një shkresë, po e bëjmë, por ne nuk kemi as tagrin, as vendimmarjen për të gjykuar.

Përgjegjës Sektori Pyje-Kullota; z.Klarsen Brako: Ne do e ndjekim në Ministri dhe patjetër dhe për problmet tona.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Që të kuptojmë diçka, hartën nuk e ndryshon bashkia, harata ka dalë me VKM.

Yllson Ibrahimllari: Ka ardhur një Relacion nga drejtoria e bashkisë, ku thuhet që ne jemi dakord mbas verfikimit që ju i keni bërë produkutit të hartave, pra ne e kemi dhënë opinionin tonë që këto harta janë të rregullta.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kur ka mbi vendosje Kadastra nuk i rregjistron.

Yllson Ibrahimllari: Po i rregjistron dhe i bën mullarë.Nëse kërkon një opinion timin, unë jam që dhe fshatrat mos kenë mosmarveshje me njëri tjetrin, por ti kenë ndarë kufijtë e tyre dhe këtu po punon mirë z.Andi, por problemi është këtu, ne kemi miratuar një produket hartografik të gabuar.Marsel Nazifi dhe z.Joahn Thoma kanë bërë realcionin, ne duhet të themi kaq, që nuk është si duhet.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ju mund ti drejtoheni Ministrisë me shkresë ose na i sillni ne si organ ekzekutiv për ta parë, ta shohim se çfarë ndodh.

Yllson Ibrahimllari: Sjellja te ju sipas të gjitha gjasave, ka dhe disa afate kohore.Kam sjellë te ju në datën 28.03.2024, propozimin për titujt e nderit, ka ndruar jetë njëri po ndron dhe tjetri kur do mblidhet Komisioni i Titujve?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ke shumë të drejtë, do e mbledhim shumë shpejt.

Petrit Kupe: Dua të ngre shqetësimin, për azhorimin e disa haratave në Nj.A Libonik, sepse është një shqetësim i banorve atje, spese nuk po bëjnë dot legalizimin e banesave.Në emër të bashkisë ti drejtohemi ASHK-së për të bërë azhorimin e kësaj parcele, kemi patur dhe konflikete atje, ndaj jam dhe përfaqësues i Këshillit atje, të ngre dhe shqetësimet e mia dhe të komunitetit.Kryetari i di problemin dhe e ka dhënë porosi të merren por ata nuk po merren.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Marrveshja me ASHK, po shkon shumë mirë, kemi mbyllur NJ.A kryesore, Vreshtas, Pirg, Libonik, ku ishte dhe më shumë ngarkesë, por kur ka probleme teknike të mbi vendosjes nuk është puna që do e zgjidhi ky grup, ne duhet ta shohim se çfarë ka, mund të kërkojë një azhornim zona, do e flas me drejtoreshën e Kadastrës, por nuk e ka në dorë një specialist i bashkisë dhe ta zgjidhim.

Faslli Zholi:E kam dhe unë si shqetësim këtë problemin e legalizmit, më kanë ardhur për matje përsëri, ndërkohë që unë e kam furtur shtëpinë për legalizim prej vitit 2006, shpresoj mos jetë me qëllim dhe të marri zgjidhje.Faleminderit.

Server Xhuti:Në fshatin Zvezdë ka toka pa rregjitruar.

Drejtori i Pronave Publike dhe Asteve; z.Andi Sula: Sa për saqrim, kuptohet që shqetësimi juaj është i drejtë, nuk duhet tja kërkoni bashkisë këtë, por është Hipoteka ajo që merret me këtë gjë dhe unë ja u garantoj, që ajo pe merret, është ngritur dhe një drejtori, që po merret posaçërisht me këtë, digjitalizim, përimirësim dhe rregjistrim fillestar në Drejtori të Përgjithshme.Drejtoria e Korçës nuk e ka tagrin për të bërë ndryshime apo matje.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Kërkojani Drejtorisë të Përgjithshme ta futë në palnin e vetë këtë që po kërkojnë.

Faslli Zholi: Kam një shqetësim nga qytetarët, që familjet që janë në emigrim, pagujnë detyrimet në bashki, kur ata nuk jetojnë këtu.Ti marrim detyrimin objeketeve që janë këtu dhe me një lishencë janë pesë biznese, punime po bëhen shumë, por doja të thoja që ti bëjnë me cilësi, sepse zgjedhjet përfunduan.Faleminderit!

Yllson Ibrahimllari: Kam edhe diçka, problemin që ngrita unë si e lamë?

Ornildi Demollari: Po do mblidhet Komisoni i Titujve.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Lidhur me shqetësimin tjetër, me relacionin që kanë firmosur Këshilltarët, ti kalojë ekzekutivit dhe ata të shprehen.Lidhur me dhënien e titujve, duhet të jemi të vetëdijshëm që nuk duhet të bëjmë qoka, titulli duhet të ketë kuptim kur jepet, duhet ta argumentoni kur vini në Komision, që çfarë ka bërë personi.

Yllson Ibrahimllari:Këtu vihet re që dhe iniciativa e Kryetarit dhe ajo e Andit, iniciativa të tjera këtu vihet re që po zgjidhen disa probleme këtu në bashki.Por në bashki kemi një konflikt tjetër, njezit që do angazhoni si në rastin e 3289 Lozhani i Ri, ku e ke çuar për regjistrimin e pronësive, mos përfshihen se kanë konflikt interesi.

Ornildi Demollari: Po.Faleminderit Doktor! Problemi që u ngrit këtu i kalon ekzekutivit dhe në një mbledhje të radhës të sjellë informacion se çfarë ka bërë.

Yllson Ibrahimllari:Kërkojmë dhe një informacion se sa është dëmi pas ngricave të muajit Prill.

Ornildi Demollari:Për titujt e nderit, do i lutesha Komisionit të Kulturës që kemi ne në Këshill të kujdeset që në një mbledhje të radhës të an vijë si material, për të marrë vendim Këshilli, të mblidhet dhe Komisioni i Titujve të Nderit në bashki.

Yllson Ibrahimllari: Mund të na bëjë një listë, Komisioni ose Ekzekutivi të të gjithë emrave që kanë marrë Tituj Nderi në bashki, do ju lutesha dhe atë stemën e bashkisë ta ndryshojmë, sepse nuk i reziston më kohës.

Ornildi Demollari: Jemi te pika 11 e rendit të ditës, Raporti për sondazhin, prioritet e qytetarve për tavanet përgatitore të buxhetit viti 2026.
Sondazhiu plotesua nga 30 persona,
3 femra dhe 27 meshkuj
43% e personave qe kane plotesuar sondazhin jane nga qyteti I Maliqit, ndersa 57% nga NJA
50% jane te grupmoshes 31-45 vjec, 33% te moshes 18-30 vjec, 17% te grupmoshes 46-60 vjec dhe 0 mbi 60 vjec.
Nder personat qe kane plotesuar pyetesorin, 13% jane te vete punesuar, 50% te punesuar ne sektorin publik, 20% jane te papune, 3% student, dhe 13% te tjere.
Nder personat qe kane plotesuar sondazhin, 2 prej tyre marrin ndihme ekonomike dhe 1 eshte me aftesi te kufizuara.
Pyetjes nese jane dakord me mënyrën se si janë shpenzuar paratë për shërbimet, qytetaret I pergjigjen se do te donin me shume financime per rrjetin rrugor rural (53%), per arsimin baze, perfshire arsimin parashkollor 50%, per kujdesin social per familjet dhe femijet 54%, per sherbime publike vendore 56%.
Pyetjes se si e vleresojne performancën e bashkisë për shërbimet kryesore të ofruara, qytetaret I pergjigjen pozitivisht per menaxhimin dhe administrimin e bashkise, per sherbimet publike vendore per kujdesin social per familjet dhe femijet, nderkohe qe per sherbimet e Arsimit baze, perfshire arsimin parashkollor, dhe per rrjetin rrugor rural kerkojne nje performance me te mire.
Kur pyeten se per cilat sherbime mendojne se duhet te shpenzohet me shume, qytetaret shprehen se duhet te shpenzohet me shume per sherbimet bujqesore, per punesimin, arsim dhe aftesim, per mbeshtetje per zhvillim ekonomik, per personat e semure dhe me aftesi te kufizuara, si dhe per turizmin.
Pyetjes nese jane të gatshëm të paguajne më shumë taksa / tarifa për përmirësimin e shërbimeve të ofruara, shumica e qytetareve I pergjigjen negativisht, perjashtuar per kopshtet dhe cerdhet ku 73% shprehen pozitivisht.
Mendimet e qytetareve do t'i percillen Ekzekutivit per t"I pasur parasysh dhe reflektuar ne dokumentin e Tavaneve buxhetore 2026.
Ornildi Demollari: Kemi dhe një informacion, që vjen nga Drejoria e Shërbimit Social, Arsimit dhe Shëndetësisë, të cilin e kemi patur në kalendarin e punës. Raport mbi gjendjen e kopshteve në territorin e bashkisë Maliq.Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, diskutime të tjera.
Pranvera Begolli:Përshëndetje! Duhet të bëjmë disa ndryshime në Komisione pas vakancës të krijuar dhe propozimeve nga grupi i opozitës.Po ju lexoj ndryshimet.
Komisioni i Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare.

1. Pranvera Begolli
2.Petrit Kupe

3. Kristina Mallelli
4. Yllson Ibrahimllari
5. Eglantina Balli

1. Komisioni i Etikës, Standarteve dhe Apelimeve.
   1.Gentiana Drabo
   2.Klea Baçi
   3.Ronaldo Skënderi
   4.Server Xhuti
   5.Lulëzim Hoxhaj
2. Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjiktë Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.
   1.Marjanthi Avrami
   2.Pranvera Begolli
   3.Petrit Kupe
   4.Eglantina Balli
   5.Andonaq Risto
3. Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve.
   1.Idlir Limllari
   2.Ilia Xhuti
   3.Rovena Terolli
   4.Albina Xhejo
   5.Faslli Zholi
4. Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural.
   1.Eriseld Jonusllari
   2.Petrit Kupe
   3.Marianthi Avrami
   4. Nersida Shindo
   5. Lulëzim Hoxhaj
5. Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit.
   1.Idlir Limllari
   2.Ronaldo Skënderi
   3.Pranvera Begolli
   4.Almir Elezi
   5. Faslli Zholi
6. Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.
   1.Dritan Çami
   2.Ilia Xhuti
   3.Floreta Zaçe
   4.Almir Elezi

5.Yllson Ibrahimllari

8 Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut.

1.Gentiana Drabo
2.Armando Dautllari
3.Plator Çollaku
4. Faslli Zholi
5. Marjeta Xhelollari

9. Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

1.Yllson Ibrahimllari
2.Drtian Çami
3.Enida Avdolli
4. Klea Baçi
5. Eglantina Balli

10. Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujrave, Mbrojtjes së Mjedist dhe Biodiversitetit.

1.Fevri Sherifi
2.Marianthi Avrami
3.Rovena Terolli
4.Albina Xhejo
5.Lulëzim Hoxhaj

11. Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes.

1.Gentina Drabo
2.Daniela Ibrahim
3.Nersida Shindo
4. Lulëzim Hoxhaj
5. Faslli Zholi

12. Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve.

1.Daniela Ibarahim
2.Almir Elezi
3. Floreta Zaçe
4. Faslli Zholi
5. Server Xhuti

13. Komisioni i Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit.

1.Armando Dautllari
2.Erisled Jonusllari
3.Gentiana Drabo
4. Albina Xhejo
5. Dalina Krekas

14. Komisioni për Marrëdhënjet me jashtë dhe Integrimin Europian.

1.Plator Çollaku
2.Xhuana Hoxhallari
3.Kristina Malelli
4. Marjeta Xhelollari
5. Lulëzim Hoxhaj

Ornildi Demollari: Kemi diçka tjetër këtu ? E kalojmë në votim ?

Kush është dakord?18 vota pro.
Kundra? Nuk ka .
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 18 vota pro, Faleminderit! Kemi diçka tjetër, kjo ishte mbledhja, ditë të mabrë.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI